

Formular për SYLLABUS të lëndës Virologji

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Titulli i lëndës:	Virologji veterinarë (BsC+MsC)
Niveli:	Mjekësi veterinarë
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III, Semestri V,
Numri i orëve në javë:	2+1 (30/15)
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Laboratori i Mikrobiologjisë, Instituti i Blegtorisë dhe Veterinarisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc.Driton Sylejmani, Prof. Dr.
Detajet kontaktuese:	driton.sylejmani@uni-pr.edu +38344 220 066
Përshkrimi i lëndës	<p>Njohuri mbi mbi virologjinë si shkencë, rëndësinë dhe morfologjinë e virusëve.</p> <p>Karakteristikat e përgjithshme të acidit nukleik viral. Shumëzimi i virusëve. Karakteristikat e përgjithshme të infeksionit viral.</p> <p>Diagnoza laboratorike e sëmundjeve virale. Kemoterapia antivirale, interferonet, induktimi i interferoneve në mjekim.</p> <p>Imunizimi kundër sëmundjeve virale, vaksinat virale. Klasifikimi i viruseve sipas Baltimor-it</p> <p>ADN virusët, ARN virusët, Bakteriofaget, Viroidet, prionet.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Njohja e studentëve me bazat teorike dhe praktike të virusëve etj. Nëpërmjet këtij informacioni të marr studentit duhet të njoh dhe dalloj virusët si dhe ti përvetësoj metodat e ndryshme të gjurmimit të virusëve me qëllim interpretimin dhe vendosjen e diagnozës në situata të ndryshme të sëmundjeve të dyshuara virale. Kjo lëndë poashtu ka për qëllim që studentit të njihet me imunizimin kundër sëmundjeve virale dhe me vaksinat virale.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Studentët pas mbarimit të kësaj lënde do të jenë në gjendje që përmes ligjëratave dhe</p>

	<p>ushtrimeve praktike të dijnë mbi virusët, morfologjinë e tyre, shumëzimin e tyre etj. Poashtu të perfeksionojë metodat e ndryshme të imazheve me qëllim interpretimin dhe vendosjen e diagnozës në situata të ndryshme të sëmundjeve të dyshuara virale.</p> <p>Duhet të kenë njohuri mbi imunizimin kundër sëmundjeve virale dhe vaksinat virale si dhe aplikimin e tyre në kafshë të ndryshme në mënyrë të veçantë të kenë njohuritë për vaksinat që aplikohen kundër sëmundjeve virale në kafshë në vendin tonë.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokiume,seminare	1	3	3
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	3	3
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ky është një kurs i kombinuar Ligjërata-Ushtrime në të cilat temat prezantohen nga Profesori i lëndës. Pjesët praktike, veprimtaritë laboratorike dhe ekskursionet shpjegohen nga profesori dhe asistenti i lëndës. Në përgjithësi prezentimet e ligjëratave do të bëhen përmes Power Pointit. Materiale shtesë do të sigurohet nga Profesori.</p>		

	<p>Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime praktike është obligativ.</p> <p>Verifikimi i njohurive do të kryhet pas përfundimit të cikleve të mësuarit. Pas përfundimit të ligjëratave është pjesë e detyrueshme testimi nëpërmjet kolokviumit përfundimtar dhe provimit me gojë.</p> <p>Leksione, seminare dhe praktika</p> <p>Mjetet: Overhead, Powerpoint , videokaseta, etj</p>
Metodat e vlerësimit:	<p>-Praktika</p> <p>-Seminare</p> <p>-Provimi përfundimtar</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>- Virologjia Veterinare. Kristaq P. Berxholi. Tiranë. 2002.</p> <p>- Quin,P.J.-Carter,M.E. Markey, B.Donnelly,W.J.C., Leonard, F.C.: Veterinary Microbiology and Microbial Disease, Blackwell. Oxford 2002. ISBN 0-632-05525-1.</p>
Literatura shtesë:	<p>-Murphy, F.A.-Gibbs, E.P. J.-Horzinek, M.C.-Studdert, M.J.:Veterinary Virology.3.kiadas San Diego-London;Academic Press, 1999.</p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Vendi dhe rëndësia e virusëve në biosferë, evoluimi i virusëve.
Java e dytë:	Morfologjia e virusëve. Karakteristikat e përgjithshme të acidit nukelik viral. Klasifikimi i virusëve sipas Baltimor-it.
Java e tretë:	Veçoritë kryesore të replikimit të virusëve. Mutacioni i virusëve dhe roli i tij në evolucionin e virusit.
Java e katërt:	Replikimi i acidit nukleik të ADN virusëve. Replikimi i acidit nukleik të ARN virusëve.
Java e pestë:	Ndërveprimet virale, interferenca. Efektet citopatike.
Java e gjashtë:	Karakteristikat e përgjithshme të infeksionit viral (Rrugët e infeksionit dhe faktorët që ndikojnë në ndërveprimin virus-qelizë mikpritëse)
Java e shtatë:	Mjekimi antiviral, interferonet. Imunizimi kundër sëmundjeve virale dhe llojet e vaksinave virale.

Java e tetë:	ADN-virusët: Virusët e Familjes Parvoviridae; Papovaviridae, gjinia Papillomavirus
Java e nëntë:	Virusët e Familjes Herpesviridae; Iridoviridae
Java e dhjetë:	Virusët e Familjes Poxviridae, gjinite Avipoxvirus, Capripoxvirus, Parapoxvirus, Leporipoxvirus, Orthopoxvirus, Suipoxvirus
Java e njëmbëdhjetë:	ARN virusët: Virusët e Familjes Picornaviridae (Aphthovirus etj) Virusët e Familjes Caliciviridae (gjinia Lagovirus etj)
Java e dymbëdhjetë:	Virusët e Familjes Flaviviridae (gjinite Pestivirus, Flavivirus)
Java e trembëdhjetë:	Virusët e Familjes Paramyxoviridae (gjinite Paramyxovirus, Morbillivirus, Avulavirus)
Java e katërbëdhjetë:	Virusët e Familjes Rhabdoviridae; Coronaviridae
Java e pesëmbëdhjetë:	Virusët e Familjes Bunyaviridae; Adenoviridae
Java	Ushtrimet që do të zhvillohen
Java e parë:	Prezentimi i temave të ushtrimeve në lëndën e Virologjisë.
Java e dytë:	Struktura e virusëve, format e tyre dhe tipare tjera. Infeksioni dhe sëmundja virale.
Java e tretë:	Ndërveprimet virale, interferenca. Efektet citopatike.
Java e katërt:	Mjekimi antiviral, interferonet. Imunizimi kundër sëmundjeve virale dhe llojet e vaksinave virale.
Java e pestë:	Mostrat që merren në rastet e sëmundjeve të dyshuara virale (gjaku, lekura, sputum, urina, sperma, fecesi, lëngu cerebrospinal, inde për biopsi apo post-mortem).
Java e gjashtë:	Përshkrimi i metodës së izolimit apo kultivimit të virusit
Java e shtatë:	Detektimi i gjenomit të ADN-ë apo ARN-së së virusëve

	përmes PCR
Java e tetë:	Metodat që bazohen në imazhet mikroskopike elektronike
Java e nëntë:	Përshkrimi i metodës së imunofluoreshencës
Java e dhjetë:	Detektimi i antitropave të mikpritësit (ELISA test)
Java e njëmbëdhjetë:	Analiza e hemoaglutinit
Java e dymbëdhjetë:	Agar-gjel imunodifuzioni
Java e trembëdhjetë:	Fiksimi i komplementit
Java e katërbëdhjetë:	Njohja me vaksinat e ndryshme kundër sëmundjeve të ndryshme virale
Java e pesëmbëdhjetë:	Mënyra e prodhimit të një vaccine virale, përbërja e saj dhe përdorimi.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.

- *Mbajtja e plan programit të prezentuar në sylabus, prezentimi i informacioneve shtesë, trajtimi i tematikava aktuale.*
- vijim i rregullt në ligjërata dhe ushtrime
- rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim
- hyrja në sallë me kohë,
- shkyçja e telefonave cellular.